



KUVENDI KOMUNAL NË MALISHEVË  
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

27.09.2006  
01/206.

**RREGULLORE**  
**PËR MENAXHIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E VARREZAVE PUBLIKE**

Shtator – 2006  
Malishevë

Në pajtim me Rregullorën e UNMIK-ut, nr.2000/45, mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, përkatësisht me nenin 3 al.3.1 shkronja ( p ) dhe nenin 4, dhe Statutin e Komunës së Malishevës, neni 9 dhe 27 al.2, Zyra e shefit Ekzekutiv dhe Drejtoria për Shërbime Publike , me datë, 12.05.2006 dhe 15.09.2006, me anë të kësaj propozon për miratim këtë :

Rregullore për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike .

## I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

Komuna do të vërë në dispozicion të gjitha mundësit e veta që ka për të bërë një menaxhim sa më efikas të varrezave publike, do të japë informata për palët e interesuara për të kuptuar sa më drejtë mënyrën dhe format e implementimit të kësaj rregullore.

a.gjithashtu komuna do të ofrojë informacione publike në lidhje me rregullimet e reja të mundshme në këtë aspekt, dhe këtë do ta realizojë përmes fushatave të ndryshme mediale.

b.komuna do të jetë ç'do herë e hapur për ndryshime, që kishin për ta begatuar këtë rregullore, dhe që këto ndryshime të jenë në favorin e qytetarit.

c.komuna gjithashtu do të mirëpresë kontributin edhe të organizatave tjera që kishin për të dhënë kontribut në rregullimin e kësaj lëmie të jetës.

### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të varrimit si dhe rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e komunës së Malishevës.

a.varrezat janë vende,ku me plan urbanistikë, komuna ka përcaktuar parcelën e caktuar për këtë destinim,

b.apo në ndonjë formë tjetër me vendim ka njohur gjendjen faktike në terren.

### Neni 2

Me shërbime të varrimit kuptojmë të gjitha punët që kanë të bëjnë, me varrimin e personave të vdekur siç janë:

- leja për zhvarrimin e eshtrave të mbetur të personave të vdekur në varrin e caktuar
- leja për vendin e varrosjes
- transporti i personave të vdekur prej vendit ku merret deri te vendi i varrimit
- hapja e varrit-vendosja,gjegjësisht mbulimi i varrit
- si dhe veprime tjera në lidhje me varrimin

### Neni 3

Varrimi mund të bëhet vetëm në varrin që është i lejuar për përdorim (sipas radhës), nëse nuk është e rregulluar në ndonjë form tjetër me ligj, apo me ndonjë formë tjetër nga komuniteti.

## Neni 4

Varrezat janë tokat të cilat janë përcaktuar për varrimin e personave të vdekur me planin urbanistik komunal apo me vendim të Kuvendit Komunal.

## Neni 5

Punët e shërbimeve të varrimit i kryen ndërmarrja komunale apo organizata të cilës Kuvendi Komunal ia ka besuar këto shërbime. Varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave nëpër fshatra e bënë bashkësia lokale (fshati) gjegjësisht komuniteti fetar i fshatit.

## VARRIMI

### Neni 6

Me varrim kuptojmë mbulimin e trupit të personit të vdekur (kufomës) apo eshtrave të personave të vdekur, gjegjësisht, vendosja e hirit të kufomës së djegur në thellësi të tokës së caktuar të varrezave.

### Neni 7

Varrimi mund të bëhet pas konstatimit të vdekjes sipas rregullave të posaçme. Varrimi mund të bëhet së paku 24 orë pas vdekjes kurse ndërmarrja për shërbimet e varrimit duhet të lajmërohet së paku 12 orë para varrimit.

### Neni 8

Ndërmarrja komunale është e obliguar që të siguroi personelin për shërbime të varrimit për çdo ditë pune (si dhe ditëve të vikendit dhe gjatë ditëve festive).

### Neni 9

Varrimi i kufomës (eshtrave të mbetur) bëhet në varrezat e vendbanimit të personit të vdekur. Varrimi i kufomës mund të bëhet edhe në vendin ku personi e ka rezervuar apo vendin ku dëshiron ta varrosë familja e të vdekurit.

### Neni 10

Lejen për varrimin në varrin e caktuar e jep Ndërmarrja komunale apo bashkësia lokale e fshatit nëpër fshatra.

### Neni 11

Transportin e kufomës (eshtrave të mbetur) duhet ta bënë Ndërmarrja komunale me automjetin special për këtë qëllim. Transportin e kufomës (eshtrave të mbetur), nëpër fshatra e bënë komuniteti fetar i fshatit (bashkësia lokale).

## Neni 12

Kufoma e personit të caktuar mund të ruhet në morg deri në kohën e varrimit nëse varrezat kanë morgun. Kufoma deri në varrim, mund të ruhet edhe në xhami, kishë apo në ndonjë objekt tjetër fetar, me lejen e bashkësisë fetare të komunitetit, si dhe me lejen e të afërmeve të vdekurit.

## Neni 13

Kufoma e personit të caktuar, me leje të organeve komunale, mund të vendoset para varrimit në një vend të caktuar, për ti shprehur nderimet ndaj të vdekurit.

## Neni 14

Nderimet e fundit ndaj të vdekurit mund të shprehen në sallën për përshëndetje (vendi i tubimit) apo pranë varrit të tij.

Gjatë varrimit mund të kryhen ceremonitë fetare që janë në pajtim me rregullat e komunitetit fetar.

## Neni 15

Djegia e eshtrave të kufomës bëhet vetëm në krematorium.

a. djegia e eshtrave të kufomës bëhet vetëm nëse i vdekuri gjat jetës, ka shprehë dëshirën që kufoma e tij të digjet.

d. djegia e kufomës që ka vdekur në mënyrë jo të natyrshme, mund të bëhet vetëm me lejen e organeve gjyqësore.

## Neni 16

Hiri i kufomës së djegur duhet të vendoset në urnë prej materialit të qëndrueshëm dhe të mbyllur hermetikisht, pastaj mbulohet në varrin e caktuar.

## Neni 17

Eshtrat e mbetur të kufomës mund të zhvarrosen dhe të barten edhe në varrin tjetër me lejen kompetente të organeve përgjegjëse dhe me lejen e inspektorit sanitar, si dhe me lejen e anëtarëve të familjes së të ndjerit.

## VARREZAT

Hapja (ndërtimi i varrezës)

## Neni 18

- a. Çdo vendbanim duhet të ketë varreza,
- b. dy ose më shumë vendbanime mund të kenë varreza të përbashkëta.

## Neni 19

Varrezat që janë në funksion duhet të kenë:

- objektet për shërbime të varrimit,
- hyrje – dalje e rrugëve,
- hapësira për përcaktimin e vendeve të varrimit sipas mundësive,
- vendi ku punohen arkivolet dhe përmendoret nëse e lejojnë mundësit,
- infrastruktura e nevojshme,
- rrethoja e varrezave.

## Përcaktimi dhe vendimi për ndalimin e varrezave.

## Neni 20

Kuvendi Komunal merr vendim që varrezat të mbeten jashtë përdorimit, apo të ndalohej varrimi i kufomave në varreza. Tokat e varrezave të shpallura jashtë përdorimit, mund të përdoren për qëllime tjera me vendim të Kuvendit Komunal dhe konform planit urbanistik.

## Neni 21

Organi mbikëqyrës mund ta ndaloj varrimin e kufomave në një pjesë të caktuar sipas udhëzimit të Ndërmarrjes komunale për menagjim të varrezave, nëse konstatohet se nuk ka vend të mjaftueshëm.

## Shfrytëzimi i vendeve të varrimit.

## Neni 22

Varri është vendi ku vendoset kufoma (eshtrat e mbetur) të personit të vdekur.

## Neni 23

Hapësira që shfrytëzohet për varre ndahet në parcela, brenda të cilave gjinden vendet për varre.

## Neni 24

Për rezervimin e varrit, vendosjen e përmendores dhe shërbimet e varrimit në lidhje me varrimin apo eks-humimin e eshtrave të personit të vdekur, paguhet çmimi që e cakton Ndërmarrja komunale.

a. nuk mund të rezervohet vendi për varrë nëse është në kundërshtim me rregullat që organi kompetent në bashkëpunim me ndërmarrjen komunale ka paraparë në varreza,

b. nuk mund të rezervohet vendi për varr, edhe në ato varreza që kanë një rëndësi të veçantë historike.

c. nuk mund të rezervohet vendi për varr, në varrezat e dëshmoreve, apo në vendet dhe pronat publike, ku bien në kundërshtim me rregullat publike të shoqërisë.

#### Neni 25

Kuvendi Komunal me vendim të posaçëm, mund të vendosë që eshtrat e të vdekurve të varrosur në varreza, të zhvarrosen dhe të vendosen në një vend tjetër, për qëllime në interes të komunës apo për shkak të ndryshimeve në planin urbanistik.

### Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave

#### Neni 26

Varrezat rregullohen dhe mirëmbahen sipas zakoneve të komunitetit në atë rrethinë, apo të atij lokaliteti-vendbanimi që ka të bëjë me respektin dhe nderimet që ata kanë ndaj të vdekurve. Në pamje, me shenja, simbole dhe mbishkrime në përmendore dhe pllaka përkujtimore, nuk duhet të ofendohen ndjenjat patriotike, fetare, apo nacionale të komuniteteve tjera

#### Neni 27

Ndërtimi, renovimi, ngritja, apo heqja e përmendores, apo pllakës përkujtimore pranë varrit, duhet të bëhet me lejen e organit kompetent, dhe atë sipas normave dhe standardeve.

#### Neni 28

Me mirëmbajtje të varrezave nënkuptojmë:

- ndërtimi dhe mirëmbajtja e varrezave, përmendoreve, pllakave etj
- mirëmbajtja e gjelbërimit
- mirëmbajtja e rrethojës së varrezave,
- rrugëve pranë varrezave,
- infrastrukurës (rryma, uji, kanalizimi, ndriçimi)
- Mbajtja e pastërtisë dhe të tjera.

#### Neni 29

Rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në qytet e kryen Ndërmarrja komunale, komuniteti fetar në bashkpunim me atë të fshatit nëpër fshatra.

#### Neni 30

Në varreza mund të kryhen edhe punë ndërtimore në lidhje me natyrën dhe qëllimin e varrezave, por me lejen e organit kompetent komunal, apo komunitetit nëpër fshatra.

#### Neni 31

Në varreza mund të vendosen lule dhe kurora lulesh, kur këto të thahen, Ndërmarrja komunale është e obliguar që ti heq ato.

#### Neni 32

Drejtoria e Shërbimeve publike është e obliguar që përmes, Ndërmarrja komunale apo komuniteti nëpër fshatra, t'i mbron varrezat nga dëmtimi, rrëzuarja apo shkatërrimi i tyre,

a. ajo do të lëshojë udhëzime të kohëpaskoshme për masat që duhet marr në mbrojtjen e varrezave,

b. rreth mbikqyrjes dhe mbrojtjes së varrezave janë të detyruar edhe shërbimi i inspektoriatit si dhe Shërbimi Policor i Kosovës.

c. varrezat dhe varret e dëshmorëve, në territorin e komunës së Malishevës, duhet të kenë mbrojtje të veçantë, nga organet përgjegjëse të komunës dhe institucionet tjera.

### Neni 33

Disa varre apo edhe varreza, sipas propozimit të organit kompetent, mund të shpallen si monumente kulturore me vendim të posaçëm nga Ministria e Kulturës, dhe njëherit ajo do të kujdeset që në bashkpunim me komunën t'i mbrojë ato.

### Neni 34

Evidencën për varreza, varrime, objekte përkujtimore dhe varrosjen e personave të vdekur e mban organi kompetent komunal, dhe Ndërmarrja komunale.

### Neni 35

Vizitorët e varrezave janë të obliguar që në varreza të sillen në mënyrë të njerëzishme, në shenjë nderimi dhe respekti ndaj të vdekurve, dhe të afërmeve të tyre.

### Neni 36

Fëmijët nën moshën 10 vjeçare kanë të drejtë të marrin pjesë (vizitojnë) varrezat vetëm në përcjellje të personave të moshuar.

### Neni 37

Drejtoria për Shërbime Publike, lëshon udhëzim administrativ, Ndërmarrjes komunale me të cilën vendosë orarin, se kur mund të vizitohen varrezat. Po ashtu mund të merr vendim për ndërprerjen e përkohshme të vizitave nëse një veprim i till është i arsyeshëm dhe ligjor.

### Neni 38

Në varreza është e ndaluar:

- të shkelen varret,
- të njollosen apo të shkatërrohen varrezat
- të shkatërrohen apo dëmtohen përmendoret, pllakat apo objektet tjera të vendosura në varreza që janë në pajtim me nenin 26 të kësaj Rregullore,
- të kërcen varret, thyhet rrethoja, të shkelet gjelbërimi, dëmtohen pemët, lulet në varreza etj,
- të futen shtazët brenda,

- të vendoset apo futet në varreza ushqimi dhe pijet e ndryshme, përveç kur lejohet me ritet fetare
- të vendosen flamuj apo shenja tjera shtetërore që janë në pajtim me nenin 26 të po kësaj Rregullore,
- të krijohet pa pastërti dhe mbeturina të ndryshme,
- të hyhet në murg pa lejen e Ndërmarrjes komunale gjegjësisht komunitetit të fshatit,
- të mbillet pemë apo lule pa lejen e Ndërmarrjes komunale-komunitetit,
- të kërkohet lëmoshë.

### Neni 39

Drejtoria për Shërbime Publike lëshon udhëzim administrativ, Ndërmarrja komunale apo komuniteti nëpër fshatra, me të cilin harton orarin, rendin dhe rregullat për hyrje dhe aktivitete tjera në varreza. Ndërmarrja komunale- komuniteti nëpër fshatra janë të obliguara që këto rregulla mbi rendin, orarin dhe aktivitetet tjera, ti shkruajnë dhe vendosin në hyrje të varrezave në një vend të dukshëm për të gjithë vizitorët.

## MJETET PËR PUNË

### Neni 40

Ndërmarrja komunale duhet ti ketë mjetet e veta të punës për kryerjen e shërbime që janë të parapara me këtë Rregullore, ndërsa organizimin e varrimit si dhe shërbimet tjera, do ta bëjë komuniteti nëpër fshatra.

Çmimi dhe tarifat e varrimit,

a. mjetet për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të qytetit, sigurohen nga shërbimet komunale të varrimit që paguajnë qytetarët dhe nga buxheti komunal.

b. çmimin e tarifës për varrime dhe shërbime komunale, aktivitete tjera, e cakton Drejtoria për Shërbime Publike në bashkpunim me Ndërmarrjen komunale, në pajtim me Rregulloren komunale për tarifa dhe ngarkesa komunale.

## MBIKQYRJA

### Neni 41

Mbikëqyrjen për mbarëvajtjen e punëve sipas kësaj rregullore e bën Drejtoria Komunale për Shërbime Publike dhe Shërbimi i Inspektoriatit.

### Neni 42

Me rastin e organizimit të ceremonisë së varrimit, Inspekcioni Sanitar së bashku me Ndërmarrjen Komunale, janë të obliguar që të marrin këto masa:

- që varrimi i kufomave të bëhet sipas normave sanitare dhe sipas kësaj Rregulloreje
- që të përcjellin realizimin e planit për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave dhe japin urdhëra për kryerje të detyrave.
- që të urdhërojnë kryerjen e punëve të caktuara mbi rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave
- që të ndalohet për kohësisht varrimi i kufomave, për arsye sanitare

- që të urdhërojnë përkohësisht varrimin në një pjesë të caktuar të varrezave
- që të ndërprejnë punën, të heqin pllakën përkujtimore apo ndonjë objekt tjetër ose të urdhërojnë që kjo të bëhet sipas normave dhe rregullave.

## DISPOZITAT NDËSHKIMORE

### Neni 43

Më të holla në shumë deri në 500 €, dënohen për kundërvajtje personat juridik si dhe personat fizik:

- a. nëse digjet kufoma e personit të vdekur në kundërshtim me nenin 15 të kësaj Rregulloreje;
- b. nëse kryen veprime të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 të kësaj Rregullore,

### Neni 44

Në mjete financiare deri në 200 €, do të dënohen për kundërvajtje personat fizik, prindi apo kujdestari i të miturit;

- a. nëse hirin e kufomës së diegur nuk e vendos në urnë, (neni 16),
- b. nëse e zhvarros kufomën dhe e bart eshtrat në varrin tjetër në kundërshtim me nenin 17,
- c. kush varros të vdekurin në vendin që nuk është i destinuar për varreza, neni (18 par.3),
- d. nëse vepron në kundërshtim me nenin (26 par.2),
- e. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 38 pika 1,2,3,4 të kësaj Rregullore.

### Neni 45

Në mjete financiare në shumën deri në 100 €, për kundërvajtje dënohen personat juridik dhe personat fizik:

- a. në rast se Ndërmarrja Komunale nuk siguron personelin për shërbime të varrimit për çdo ditë, në pajtim me rregullat e parapara të kësaj Rregullore,
- b. nëse kufomat varrosen jashtë vendbanimit të personit të vdekur pa leje përkatëse (neni 9 par.1),
- c. nëse Ndërmarrja komunale ose bashkësia lokale veprojnë në kundërshtim me nenin 10,
- d. nëse Ndërmarrja komunale vepron në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 1,
- e. nëse kryen veprime në kundërshtim me nenin 24,
- f. nëse Ndërmarrja komunale kryen veprime në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 2,
- g. kush kryen veprime të cilat bien në kundërshtim me nenin 27,
- h. nëse Ndërmarrja komunale vepron në kundërshtim me nenin 29,
- i. të gjithë ata që kryejnë veprime që bien ndesh me nenin 32,
- j. kush kryen veprime, që bien në kundërshtim me nenin 38 pika 5,6,7,8 dhe 9, të kësaj Rregullore.

#### Neni 46

Me të holla deri në 50 €, do të dënohen për kundërvajtje personat juridik dhe personat fizik;

a.nëse Ndërmarrja komunale nuk vepron në pajtim me nenin 31 paragrafi 2,

b.nëse vizitorët nuk veprojnë në pajtim me nenin 35 të kësaj Rregullore,

#### Neni 47

Me mjete financiare në shumën prej 25 €, do të dënohen personat juridik dhe fizik që veprojnë në kundërshtim me nenin 39. Gjoha do të paguhet në vendin e ngjarjes.

#### Neni 48

Nëse familjarët e të vdekurit veprojnë në kundërshtim me nenin 7, të kësaj Rregullore të gjitha pasojat që do të mund të paraqiten mëpastaj di t'i bartë ajo, duke llogaritur këtu edhe shpenzimet e jashtëzakonshme.

#### Neni 49

Nëse familjarët e të vdekurit veprojnë në kundërshtim me nenin 13, me vendim organi komunal mund të ndërpresë ceremoninë e organizuar paraprakisht.

#### Neni 50

Denimet me të holla në vendin e ngjarjes mund ta shqiptojnë inspektorët komunal dhe Shërbimi Policor i Kosovës.

#### Neni 51

Për shkelje të rregullave të sjelljes të parapara me këtë Rregullore, për këto shërbime, nga ana e të miturve, do të dënohen me kundërvajtje prindërit e të miturit ose kujdestari i të miturit.

#### Neni 52

Ndaj të miturve të cilët shkelin rregullat e kësaj Rregullore, do të zbatohen procedurat ligjore duke u shqiptuar masat adekuate për të mitur të parapara me ligj.

#### Neni 53

Çdo gjë që nuk e parasheh kjo rregullore, mund të rregullohet me akte normative të veçanta që i vendosë Kuvendi Komunal i Malishevës, ndërsa ekzekutimin do të bëjë përmesë Drejtorisë për Shërbime Publike dhe shërbimit të inspektoriatit.

#### Neni 54

Në rastë se ndonjë dispozitë e kësaj Rregullore bie ndesh, me ndonjë ligj të veçant apo me ndonjë akt të organeve më të larta, do të zbatohen dispozitat e ligjit dhe akteve tjera.

#### Neni 55

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit përfundimtar të sajë.

Kryetari i Kuvendit  
Gani Krasniqi

